



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

**Terma Reference për organizim Eventi Sportiv, Ndeshje te Ekipeve Sportive pjese e Projektit
“Ekipet Sportive ne Shkolla” Qarku Vlore, për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)
Ref: Organizim Eventi no.1 03/23**

Tabela e Përmbajtjes

<i>Terma Reference për Prodhimin e materialeve Eventi Sportiv për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)</i>	<i>1</i>
<i>Ref: Audio -Visual no.1 03/23</i>	<i>1</i>
1. Rreth KOKSH	2
2. Rreth shërbimit të kërkuar	2
3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi	3
4. Metodologjia dhe plani i punës	4
5. Kualifikimet e nevojshme	4
6. Procesi i aplikimit	5
7. Dorëzimi i ofertave	5
8. Afati i Aplikimit	6
9. Procesi i Vlerësimit	7



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

2. Rreth shërbimit të kërkuar

Për të përmbushur misionin e organizatës dhe për të shpërndarë frymën Olimpike më tej, KOKSH planifikon të organizojë ndeshjet në rang Lokal, Qarku dhe Rajoni si dhe ndeshjet e kampionateve nën Projektin Ekipet Sportive në Shkolla nën KOKSH.

KOKSH kërkon të pajtojë shërbime organizim eventit sportive, “Ndeshje ndërmjet ekipe sportive të projektit në qarkun e Vlorës” në datë 15 & 16 Mars 2023.

Kërkohet një individ/ekip/kompani me integritet të lartë profesional, me eksperiencë të provuar në shërbimet e kërkuara dhe që është i interesuar të bashkëpunojë me KOKSH për tu angazhuar në aktivitetet e KOKSH.

Nëpërmjet kësaj thirrje të hapur, KOKSH fton individët/ekipet/kompanitë e



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

interesuara të paraqesin ofertën e tyre sipas specifikimeve të mëposhtme, duke përfshirë paisjet që do përdoren, skenografinë, printimin e banerave organizimin skenografik dhe teknik të ambientit në të cilin do të organizohen ndeshjet e ekipeve sportive të Qarkut Vlorë.

3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi

- Të zhvillojë një event sportive për të promovuar aktivitetin e ekipeve sportive të Qarkut Vlorë pjesë e projektit Ekipet Sportive në Shkolla për një afat dy ditor.
- Të angazhojë publikun e gjerë në promovimin e çështjeve të sportit dhe shëndetit, dhe të ngjallë dialog rreth temës duke arritur deri tek të rinjtë që janë aktivë në mediat sociale.
- Të bëhet e mundur që aktivitetet të caktuara të ndiqen “live” përmes platformave të ndryshme.
- Rritja e ndërgjegjësimit publik për çështjet kryesore për të cilat KOKSH është anagazhuar të promovojë.

Duke mbajtur parasysh sa më sipër, KOKSH po kërkon të bashkëpunojë me indiv/ekip/kompani entuziast dhe profesionist, të cilët kanë aftësi të realizojnë organizim eventit sportiv për një periudhë dy ditore në Qytetin e Vlorës. Është kusht që organizimi i eventit të tregojë profesionalizëm, dhe në përputhje me misionin dhe



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

vizionin e KOKSH.

4. Metodologjia dhe plani i punës

5. Do të kontaktohet indiv/ekip/kompani i cili do të propozojë idenë më krijuese dhe inovatore që i shërben përmbushes së qëllimeve të vendosura në këtë thirrje.
6. Orientimi do të jepet nga ekipi i KOKSH në lidhje me detyrën/punën për të zhvilluar materialet audio-vizuale.
7. Indiv/ekip/kompani do të duhet të njohë mire ambjentet ku do organizohen ndeshjet.
8. Indiv/ekip/kompani do t'i sigurojë vetë të gjitha pajisjet teknologjike të nevojshme për të relizuar aktivitetin.

9. Kualifikimet e nevojshme

Nën mbikëqyrjen e KOKSH, indiv/ekip/kompani do të prezantojë një plan të organizimit të eventit.

Meqënëse shërbimet e kërkuara për organizim eventesh sportive kërkojnë aftësi dhe teknologji specifike, fituesi duhet të përmbushë kualifikimet si më poshtë.

Kualifikimet:





KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

- Të ketë të paktën 4 vjet eksperiencë në fushën e shërbimeve të kërkuara.
- Të ketë eksperiencë të mëparshme për organizimin e aktiviteteve sportive.
- Të ketë njohuri bazë për rregullat e sporteve më popullore
- Të ketë eksperiencë të provuar për organizimin e skenografise
- Të ketë eksperiencë shërbim logjistik për ndriçim dhe audio për evente të mëdha sportive.
- Të ketë eksperiencë në kontraktimin e fotografëve dhe kameramanëve.
- Të disponojë teknologjinë e nevojshme për këto qëllime.

10. Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Një ofertë me materialet e nevojshme teknike organizative dhe të ndricimit dhe mënyrën e vendosjes për të arritur qëllimet e paraqitura në këtë thirrje.
- Nëse jeni i rregjistruar në QKB një kopje të ekstraktit dhe nëse jeni individ një kopje të ID.

11. Dorëzimi i ofertave

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në adresën:





KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Tirana Olympic Park

Rr. "Liman Kaba"

Tiranë, Shqipëri

P.O. Box 63

12. Afati i Aplikimit

Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 01.03.2023 jo më vonë se ora 16:00.





KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

13. Procesi i Vlerësimit

Përshkrimi	Pesha në vlerësim %
Eksperiencat e punës/CV e firmës/individit	35%
Ka firma/individ 4 vjet eksperiencë?	20%
Është metodologjia e propozuar e duhura për arritjen e qëllimeve të vendosura?	20%
Specifikimet e pajisjeve teknike	15%
Ka firma/individ njohi bazë për sportin	10%

